



Prishtinë, 12.07.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1016\_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);

në seancën e mbajtur me datë 12.07.2018, nxori këtë:

## VENDIM

### I. MIRATOHET dokumenti “RREGULLA DHE METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E BILANCEVE TË ENERGISË”

#### Arsyetim

- Sipas ligjit për Energjinë - Nenin 8: “Metodologjia, rregullat dhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit të Bilancit Vjetor dhe Bilancit Afatgjatë të Energjisë përcaktohen me rregullore të veçantë që hartohet dhe miratohet nga Rregullatori”.
- Deri në hyrjen në fuqi të ligjeve të reja të sektorit të energjisë përgjegjësia për miratimin e bilanceve të energjisë ka qenë te Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe është vepruar bazuar në një dokumentin *Metodologjia për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)*.
- Duke u bazuar në këto kërkesa ligjore (ZRRE) ka përgatitur dokumentin Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë. Dokumenti ka qenë në diskutim publik dhe janë dhënë komente nga palët si Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe KOSTT, të cilat komente janë përfshirë në dokument.
- Dokumenti ndahet në dy pjesë kryesore: a) Rregulla që përmban elementet e përgjithshme përfshirë bazën ligjore, përkufizimet, institucionet relevante etj., dhe b) Metodologjia që paraqet të dhënat që duhet të përmbajnë bilancet e energjisë, afatet kohore të kryerjes së aktiviteteve përkatëse, si dhe shtojcat me format e pyetësorëve për mbledhjen dhe përgatitjen e të dhënave.
- Sipas ligjit kërkohet që të trajtohet edhe bilanci për energjinë elektrike, energjinë termike dhe



gazit natyror, por meqë nuk ka sistem të gazit ende në Kosovë, për arsye praktike gazi natyror nuk trajtohet në këtë dokument, kështu dokumenti trajton vetëm energjinë elektrike dhe energjinë termike. Kur të zhvillohet rrjeti i gazit natyror në Kosovë, Rregulla duhet të amandamentohet për përfshirjen edhe të gazit natyror.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit ka vlerësuar se dokumenti është në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë dhe përmes këtij vendimi ka miratuar dokumentin **“Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë”**

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë**


Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar